



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Fakulteti Ekonomik

PRISHTINË

RREGULLORE MBI STUDIMET MASTER

Shtator, 2008

Në mbështetje të nenit 105 dhe nenit 131 të Statutit të Universitetit të Prishtinës – përkitazi me organizimin e studimeve master, Këshilli i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më **1.09.2008, aprovoi këtë:**

Rregullore mbi studimet master

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Me Rregulloren mbi studimet master (në tekstin e mëtejme-Rregullore) përcaktohet mënyra e organizimit të studimeve master dhe llojet, kushtet e regjistrimit vijues të studimeve, provimet dhe suksesi në provime si dhe përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës master.

Organizimi dhe llojet e studimeve.

Neni 2.

Fakulteti Ekonomik organizon studime të rregullta master për fitimin e gradës akademike në lemenjtë e përcaktuar me planin dhe programin mësimor të studimeve master.

Fakulteti Ekonomik mund të organizojë studimet master edhe në bashkëpunim me fakultetet tjera të Universitetit të Prishtinës. Për këtë qëllim mund të ofrojë programe dylëndore dhe programe ndërdisiplinare të studimeve.

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës mund të organizojë studimet master dhe në bashkëpunim me fakultetet tjera të Universiteteve tjera jashtë vendit, mbi bazën e programeve të përbashkëta të studimeve dhe memorandumeve për partneritet.

Neni 3.

Studimet master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) dhe kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS).

Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit e të cilat njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane) ose institucioni i cili është pranuar nga një agjensi ndërkombetare e akreditimit .Ekuivalentimi dhe nostrifikimi i certifikatave –diplomave të jashtme e bën Ministria e Arsimit Shkencës e Teknologjisë në bazë të ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

Studentët të cilët në studimet bachelor kanë arritur notën mesatare 7.5 e më tepër, mund të regjistrohen drejtpërdrejt në studimet master. Përzgjedhja e kandidatëve deri te numri i

paraparë me konkurs bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve bachelor.

Në rastet kur numri i kandidatëve të paraqitur është më i vogël se numri i shpallur me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe studentë me notë mesatare nën 7.5 por ata do t'i nënshtrohen provimit kualifikues, mbi bazën e kriterëve të cilat i përcakton Fakulteti.

Neni 4.

Të drejtën e dhënies së mësimit master e ka personeli mësues në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent) i cili i plotëson kushtet e parapara me statutin e Universitetit të Prishtinës. Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve, seminareve në studimet master e kanë edhe asistentët me së paku titullin e magistraturës ose diplomë ekuivalente me të.

Në raste të caktuara në një lëndë mësimore mund ta mbajnë mësim dy ose më shumë mësues. Në rastin kur mësimin e mbajnë më shumë mësues në indeks shënohet emri i bartësit të lëndës.

Neni 5.

Të drejtën e organizimit të studimeve master e kanë këto departamente:

1. Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet
2. Departamenti i Menaxhmentit
3. Departamenti i Marketingut
4. Departamenti i Ekonomiksit

Neni 6.

Studimet master i udhëheq kolegji i studimeve master të departamenteve përkatëse. Kolegjiumin e përbëjnë të gjithë mësuesit të cilët janë të angazhuar në realizimin e programeve studimore-master në departamentet gjegjëse.

Listën e mësuesve të propozuar nga Departamentet për realizimin e programit në studime master e aprovon Këshilli i Fakultetit.

Kolegjiumin e studimeve master e udhëheq Prodekani për Mësim.

Neni 7.

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike dhe punës në terren, ekskurzioneve profesionale dhe shkencore – mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavaruara të studenteve, si dhe punimit përfundimtar (diplomës) për arritjen e titullit master.

Kushtet e regjistrimit në studime

Neni 8.

Fakulteti Ekonomik në Prishtinë, regjistron studentë sipas mundësive kadrovike e teknike, të nevojave të shoqërisë dhe tregut .

Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinj e jep departamenti përkatës dhe e miraton Këshilli i Fakultetit.

Vendimin përfundimtar mbi shpalljen e konkursit publik e bën Senati i Universitetit të Prishtinës.

Neni 9.

Përzgjedhja e kandidatëve sipas nenit 3 (tre) të kësaj Rregullorje e bën Komisioni përkatës më së paku 3 anëtarë, të cilin e zgjedh Këshilli i Fakultetit.

Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas lemisë së studimeve.

Komisioni në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit e shpall ranglistën e kandidatëve që kanë aplikuar.

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master mund të ushtrojnë ankesë me shkrim në Dekanat brenda dy ditëve të punës pas publikimit të rezultateve.

Vendimi për kërkesat e ushtruara merren në afatin prej dy ditë pune pas ushtrimit të ankesës.

Neni 10.

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit të Prishtinës, kurse indeksin e studentit e nënshkruan Sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës.

Neni 11.

Me rastin e konkurimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumentë :

- çertifikatën e ditëlindjes
- diplomën (çertifikatën) e kryerjës së fakultetit
- vendimin mbi njohjen e shkollimin e jashtë vendit

kandidatet e pranuar për regjistrim paraqesin :

- fletëregjistrimin e plotësuar i cili mirret me rastin e regjistrimit;
- tri fotografi (formati 4,5 x 6cm);
- pagesën në lartësi të përcaktuar nga Universiteti i Prishtinës.

Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e studenteve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinjë në librin amzë, në programin e veçantë në kompjuter dhe formon dosjën e studentit.

Ndërrimi i programit – drejtimit të studimeve

Neni 12.

Për ndërrimin e programit të studimit ose transferimit prej fakultetit të UP-se ose nga ndonjë Universitet tjetër jashtë vendit në Fakultetin Ekonomik, vlejné dispozitat e parapara me Statutin e Universitetit të Prishtinës konform nenit 150.

Kohëzgjatja e studimeve

Neni 13.

Studimet master zgjasin 2 vjet, katër semestra dhe në çdo semester me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS , qe do të thotë se për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 120 kredi të ECTS.

Studenti me kushte të përcaktuara me Statutin e UP-se e ruan statusin e studentit të rregullt edhe për dy vite të tjera.

Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë për një semester.

Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit.

Neni 14.

Personi i regjistruar në Fakultetin Ekonomik e ka statusin e studentit të rregullt.

Statusi i studentit dëshmohet me indeks ose me ndonjë dokument ekuivalent .

Në rast të humbjes së indeksit me lejen e Dekanit të Fakultetit studentit i ipet “indeksi duplikat” Kërkesës për indeks duplikat duhet t’i bashkangjitet dëshmia se indeksi është shpallur i pavlefshëm dhe se është bërë pagesa sipas rregullores.

Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit janë të rregulluara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

Këshilli i Fakultetit i përjashton nga Fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prishtinës.

Humbja e statusit të studentit rregullohet me nenin 158 të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Të drejtat dhe obligimet e studenteve

Neni 15.

Të drejtat dhe obligimet e studentëve që janë përcaktuar me nenin 155 dhe 156 të Statutit të Universitetit të Prishtinës të datës 5 korrik 2004 vlejnë edhe për studentët e studimeve master në Fakultetin Ekonomik të UP-së.

Neni 16.

Përcaktimi i përgjegjësise disiplinore të studentëve më për së afërmi rregullohet me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Universitetit të Prishtinës.

Neni 17.

Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të shqiptuar nga organet e Fakultetit që kanë të bëjnë me të drejtat ,obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Ankesat e tilla i dorëzohen Komisionit të studimeve të Fakultetit brenda 8 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e shqiptuar Këshillit të Fakultetit brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.

Ankesa rreth vendimit të shkallës së parë vendoset nga Senati i Universitetit.

Kushtet e regjistrimit të vitit

Neni 18.

Senati i Universitetit të Prishtinës me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.

Provimet dhe sukcesi në provime

Neni 19.

Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të paraqesin dhe të japin provime. Provimet jepen nga të gjitha lëndët e parapara me planin e studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndës përkatëse. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i kryej obligimet që parashihen me programin mësimor.

Provimet mbahet me shkrim, me gojë ose me shkrim dhe me gojë. Kur provimi përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, studenti mund të hyjë në provim me gojë, vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notën pozitive.

Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe këto forma pune: Kolokviumi, punimi seminarik, testi dhe ushtrimet praktike.

Neni 20.

Provimet në studimet master mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të lejuara me statut të UP-së dhe me udhëime të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

Neni 21.

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

Nota shënohet me numë dhe me tekst në fletëparaqitje dhe në indeks.

Fletëparaqitjet dhe procesverbali i provimit i dërgohen referentit i cili më së voni 2 ditë pas kryerjes së provimit e regjistron në kopmjuter, librin amzë dhe në dosjen e studentit.

Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve në departamentet përkatëse.

Neni 22.

Për studentët të cilët nuk janë të kënaqur me vlerësimin dhe notën e marrënë provim, vlejné dispozitat e Statutit të UP-së të nenit 127.

Punimi i diplomës – teza për master

Neni 23.

Studimet master në Fakultetin Ekonomik përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e diplomës për master në pajtim me programin e studimeve.

Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marrë temë e diplomës për master.

Neni 24.

Mësimdhënësit të cilët marrin pjesë në mbajtjen e mësimit në studimet mastet, gjatë vitit akademik i propozojnë Kolegjiumit të studimeve master një apo më tepër tituj të temave për punimin e tezës për master me arsyetim përkatës. Mësimdhënësi që ka propozuar temën është mentor potencial i asaj teme.

Këshilli i Fakultetit me vendim të veçantë do të vendos për numrin e temave të diplomës – tezës master për të cilat një mësime dhënë mund të jetë mentor gjatë një viti akademik. Studentët, në marrëveshje me mësime dhënësit e lëndës, mund të propozojnë tituj tjerë të temave të diplomës – tezës për master.

Neni 25.

Punimi për master elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studenti.

Neni 26.

Punimi i diplomës për master mund të elaborohet bashkë me nga dy ose tre studentë (grup kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

Neni 27.

Propozimi me shkrim për lejimin e temës së diplomës – tezës master duhet të përmbajë: titullin me arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin shkencor të punimit, hipotezat themelore që do të merren për bazë dhe instrumentet që do të zbatohen realizimin e hulumtimit.

Neni 28.

Këshilli i Fakultetit me propozim me shkrim të departamentit përkatësisht të kolegjiut të studimeve master miraton titullin e propozuar dhe lejon punimin e diplomës – tezës master. Me këtë rast Këshilli emëron mentorin i cili e udhëheq studentin gjatë punës në temën e punimit të diplomës – tezës për master.

Neni 29.

Punimi i diplomës – teza master paraqet punim të pavarur profesional të kandidatit me të cilin ai tregon që ka përvetësuar njohuri dhe mundet me parashtruar dhe me zgjidh probleme dhe detyra profesionale – shkencore.

Neni 30.

Kandidati në afat prej më së shumti një viti pas vërtetimit të semestrit të katër të studimeve master duhet të dorëzojë punimin e përfunduar me shkrim të diplomës për vlerësim.

Me kërkesë të kandidatit, Këshilli i Fakultetit mund të caktoj një afat të ri më së shumti deri në gjashtë muaj për të dorëzuar punimin e diplomes –masterit. Arsyet për shtyerjen e afatit i vlerëson Këshilli i Fakultetit.

Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të diplomës –masterit. Arsyet për shtyrjen e afatit i vlerëson Këshilli i Fakultetit.

Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të diplomës-masterit për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, kandidati duhet ta rifillojë procedurën për lejimin e punimit të diplomës me temë të re, përkatësisht ta rikthej statusin e studentit të rregullt në pajtim me nenin 159 dhe 160 të Statutit të UP-së.

Neni 31.

Pas dorëzimit të punimit të përfunduar të diplomës për vlerësim Këshilli i Fakultetit, me propozim të Kolegjiut të studimeve të departamentit përkatës, ngrit komisionin për vlerësimin e punimit të masterit në afatin prej 60 ditësh prej ditës të paraqitjes të kërkesës të kandidatit.

Detyrë e komisionit është që pas shikimit të punimit, ti paraqet raport me shkrim Këshillit të Fakultetit në afat jo më të gjatë se tre muaj.

Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës – master, me shumicë të anetarëve vet, i propozon Këshillit të Fakultetit që :Punimi të miratohet dhe kandidatit ti lejohet mbrojtja,ose punimi të plotësohet apo punimi të refuzohet.

Anëtari i komisionit i cili nuk pajtohet me propozimin nga alinea paraprake e këtij neni është i detyruar që mendimin ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.

Neni 32.

Komisioni për vlerësimin e punimit të diplomës –master përbëhet prej tre anetarëve .

Sipas nevojës, Këshilli i Fakultetit mund të formojë komisionin prej pesë anetarësh. Anëtar të komisionit mund të jenë mësimdhënësitë në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent).

Neni 33.

Në bazë të propozimit të komisionit Këshilli i Fakultetit mer vendim përfundimtar për raportin e komisionit, vlefshmërinë e punimit të diplomës –master dhe lejimin e mbrojtjes publike. Komisioni për mbrojtje formohet në përbërje të përcaktuar me nenin 32 të kësaj Rregulloreje. Mentori nuk mund të jetë kryetar i komisionit për mbrojtjen publike të punimit të diplomës master.

Neni 34.

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga komisioni perkatës ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet propozimin me shkrim për titullin e ri të punimit të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm një herë.

Neni 35.

Në qoftë se Këshilli i Fakultetit ia kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, me atë rast mundet ta zgjerojë komisionin për vlerësimin e punimit të plotësuar. Kandidati duhet ta bëjë plotësimin e punimit të masterit në afatin për më së largu gjashtë muaj.

Kur Komisioni pranon punimin e plotësuar, është i obliguar që të hartoj raport të ri mbi vlerësimin e punimit dhe të njëjtin t'ia dërgoj Këshillit të Fakultetit me afat prej 30 ditësh, prej ditës kur e ka pranuar punimin.

Neni 36.

Punimi i masterit i vlerësuar pozitivisht nga anëtarët e komisionit, në afatin prej 15 ditësh jepet në diskutim publik së bashku me raportet e komisionit në sekretarinë e Fakultetit. Gjatë diskutimit publik, punimi jepet në dispozicion që të shikohet nga të interesuarit të cilët mund të japin vërejtje dhe sygjerime eventuale.

Neni 37.

Këshilli i Fakultetit, pas kalimit të afatit nga neni paraprak dhe miratimit të raportit të komisionit mbi vlerësimin pozitiv të punimit të masterit, e formon komisionin për mbrojtjen publike të punimit të masterit.

Komisioni në marrëveshje me kandidatin e cakton datën dhe vendin (sallën) e mbrojtjes publike të punimit. Mbrojtja publike e punimit të masterit duhet të bëhet brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 5 ditë dhe as më i gjatë se 30 ditë prej ditës së nxjerrjes së vendimit .

Neni 38.

Sekretariati i Fakultetit jep lajmërimin për mbrojtjen e punimit të masterit 7 ditë para ditës së mbrojtjes. Lajmërimi jepet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, dhe në Web faqen e Fakultetit. Në lajmërim jepen të dhënat për kandidatin, tema e punimit dhe që mbrojtja është publike.

Procedura e mbrojtjes

Neni 39.

Kryetari i komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit si dhe paraqet të dhënat biografike dhe bibliografike të kandidatit. Mentori në pika të shkurtra e paraqet raportin të komisionit për vlerësimin e punimit të masterit.

Kandidati bënë një prezantim – paraqitje të përmbledhur të punimit, por jo më gjatë se 30 minuta.

Anëtarët e komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë verifikimin e autorësisë të punimit dhe vlerësojnë nivelin e njohjes së problematikës që trajtohet në punim.

Neni 40.

Kryetari i komisionit e bënë përfundimin e mbrojtjes dhe fton komisionin që të mblidhet për të bërë vlerësimin dhe marrur vendimin përfundimtar për mbrojtje publike.

Vendimi i komisionit shpallet publikisht para auditorit.

Neni 41.

Kandidati ka mbrojtur punimin e masterit nëse shumica e anëtarëve të komisionit kanë dhënë vlerësimin pozitiv për mbrojtjen e punimit.

Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e masterit, ai mund të paraqet propozim të ri të punimit të masterit brenda gjashtë muajve prej ditës së njoftimit se nuk e ka mrojtur publikisht punimin e masterit.

Neni 42.

Pas përfundimit të studimeve dhe mbrojtjes me sukses të tezës së masterit, kandidati fiton thirrjen akademike master i fushës përkatëse.

Pas fitimit të thirrjes akademike master, kandidati nga shërbimet përkatëse të Fakultetit Ekonomik dhe Universitetit të Prishtinës merr çertifikatën e nënshkruar nga dekani dhe diplomën e nënshkruar nga dekani dhe rektori.

Fakulteti dhe Universiteti mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

Neni 43.

Kandidatit thirrja e masterit mund ti kontestohet dhe ti mirret nëse konstatohet se punimi i masterit është plagjiat ose është ndonjë falsifikim.

Në rast të dyshimit të bazuar, Këshilli i Fakultetit e formon komisionin prej tre anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit .

Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e komisionit dhe nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërme të këtij neni, i propozon Senatit të UP-se marrjen e thirrjes së masterit.

Senati i Universitetit të Prishtinës e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

Dispozitat kalimtare

Neni 44.

Kjo rregullore me propozimin e këshillit të fakultetit miratohet nga Senati i Universitetit të Prishtinës.

Për të gjitha çështjet tjera mbi të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të UP-se dhe ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosoves.

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i Univeristetit të Prishtinës.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.

Dekani i Fakultetit

Prof.ass.dr.Rrustem Asllanaj